



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202200697/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda:** Rekomandim për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë në Gjirokastrë.

**Drejtuar:** Drejtues i Parë Bledar ÇELIKU  
Drejtues i DVP Gjirokastrë

**GJIROKASTËR**

**Kryekomisar Ervis PEZA**  
Shef i Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë

**GJIROKASTËR**

**Për dijeni:** Drejtues Madhor Gledis NANO  
Drejtues i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisariatin e Policisë në Gjirokastrë.

Inspektimi u krye në datën 09.05.2022, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi

*dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm<sup>1</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas që iu është privuar liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit të Policisë Gjirokastër z.Ervis Peza dhe shefin e rendit z.Klaudio Mixha, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, grupi i inspektimit u informua nga shefi i rendit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me trajtimin e personave në mjediset e komisarariatit të policisë, si dhe për përmirësimin e kushteve infrastrukturore në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, sipas normave dhe parametrave të ndërtimit dhe të funksionimit të dhomave të sigurisë dhe dhomave të shoqërimit, të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i monitorimit inspektoi gjendjen e kushteve infrastrukturore në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, u njoh me dokumentacionin që administrohej nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit dhe përgjegjësi i dhomave të sigurisë, plotësimi i saktë i rubrikave lidhur me trajtimin dhe kërkesë/ankesat e personave të shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar, si dhe inspektoi zyrat e punës të punonjësve të policisë që kryenin veprime procedurale hetimore me personat e shoqëruar apo me personat e dyshuar për vepra të ndryshme penale në këto ambiente.

Drejtuesit e komisarariatit dhe punonjësit e policisë në Gjirokastër, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nga inspektimi i mëparshëm, Komisariami i Policisë Gjirokastër, me shkresë nr.2238/2 prot., datë 09.08.2021 dërguar institucionit të Avokatit të Popullit, na informon se: “*Nga ana e Komisarariatit të Policisë Gjirokastër i është dërguar për njohje DVP Gjirokastër si dhe u është kërkuar bashkëpunimi dhe marrja e masave që nëpërmjet shërbimeve të burimeve njerzore dhe trajnimeve, sektorit*

---

<sup>1</sup> Shkresë nr.K4/133-2 prot., datë 02.08.2021 dergohet “*Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Gjirokastër*”.

*ekonomik/IT, Sektorit të rendit dhe policimit në komunitet, kryerjen e të gjitha procedurave të duhura për realizimin e rekomandimeve tuaja, për përmirsimin e kushteve të ambienteve të dhomave të shoqërimit e dhomave të sigurisë, krijimin e një ambienti për intervistimin e personave të shoqëruar, të mitur dhe regjistrave përkatës etj”.*

Ndërsa nga inspektimi u evidentua se:

1. Ishte realizuar rekomandimi, për vendosjen në zyrën e informacionit të regjistrit për evidentimin e të dhënave të të miturve që shoqërohen në mjediset e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë.
2. Ishte realizuar rekomandimi, për krijimin e një ambienti (dhomë) më vehte për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe jo në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Gjithashtu, grupi i inspektimit evidentoi se:

1. Nuk ishte realizuar rekomandimi për miratimin e ndryshimit në strukturën organike të DVP Gjirokastrë të emërimit “ndihmësmjek” me “infermier”, i cili kryen vizitat mjekësore me personat e arrestuar/ndaluar, si dhe plotëson kartelat mjekësore për gjendjen shëndetësore të tyre, sipas përcaktimeve në kreun V, pika 7 të procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

Në përfundim të inspektimit u konstatua se, gjendja e kushteve infrastrukturore në mjedisin e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisarariat e Policisë Gjirokastrë, si dhe standardet e trajtimit të personave që mbahen dhe qëndrojnë në mjediset e komisarariatit në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 109 të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, ishin konform akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve ndërkombëtare. Por, pavarësisht këtij konstatimi, në këtë komisarariat ishin të pranishme dhe disa problematika, referuar si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarariat e Policisë Gjirokastrë, ambienti i shoqërimit në tërësi është i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së komisarariatit dhe kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi të ndara më vehte për gra, persona në moshë madhore dhe për të mitur<sup>2</sup>. Ato ishin të pajisura me orëditë e nevojshme si karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar dhe tavolina pune, me këmbë të fiksuara në dysheme. Përmasat teknike të

---

<sup>2</sup> *Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

dhomave janë 4x3m dhe kapaciteti për qëndrimin ulur ishte për 3-4 persona për secilën dhomë.

Në momentin e inspektimit, **dhoma e shoqërimit për të mitur ishte e mbyllur**. Sipas informacionit të shefit të rendit, kjo dhomë ishte në fazë rikonstruksioni. Në këto kushte, të miturit në konflikt me ligjin që shoqëroheshin në mjediset e komisariatit të policisë, mbaheshin dhe intervistoheshin në ambientet e “Njësisë për intervistimin e të miturve”, projekt i mbështetur nga UNICEF dhe Qeveria e Norvegjeze, në kuadër të programit “Qasja e fëmijëve në drejtësi 2019 – 2020”.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin e shtetasve deri në 10 orë, sipas afatit kohor të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore. Ato kishin dritare me përmasa të tilla që siguronin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej një tualet për meshkuj, ndërsa një tualet tjetër ndodhej brenda në dhomën e shoqërimit për gratë. Ato ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, si dhe ishin të pajisura me nyje hidrosanitare dhe kishin furnizim me ujë të rrjedhshëm.

Mjedisi i shoqërimit ishte i monitoruar me sistemin e kamerave, pamjet e të cilave monitoroheshin nga salla operative dhe ruheshin deri në 30 ditë. Në korridor dhe brenda në dhomat e shoqërimit ishin të vendosura postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në gjuhën shqipe.

Për shtetasit e huaj që shoqëroheshin në mjediset e policisë, jepej karta e të drejtave e cila ishte përkthyer në 8 gjuhë të huaja kryesore.

Nga inspektimi u evidentua se, intervistimi i personave të shoqëruar aktualisht kryhej përgjithësisht në dhomën (sallën) e SPZ-ve, ndryshe nga inspektimi i vitit të kaluar ku marrja në pyetje e personave të shoqëruar dhe intervistimi i tyre, kryhej vetëm në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Në përfundim, ky dokument plotësohej në dy kopje, një kopje e të cilit pasi firmosej i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje mbahej nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe zyrat e intervistimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që ekspozojnë dhunë

apo të mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave si dhe kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në kohën e inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati. Ndërsa nga verifikimi i regjistrit, për periudhën Janar – Maj 2022, ishin evidentuar të dhënat për **347 persona të shoqëruar** në mjediset e këtij komisariati, nga të cilët 14 persona ishin gra, 1 i mitur dhe 332 ishin persona në moshë madhore.

Dhomat në ambientin e shoqërimit ishin të emërtuara me etiketë dhe ishin funksionale, me përjashtim dhomës për të mitur e cila ishte duke u rikonstruktuar. Ambienti ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjeno-sanitare.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Ambienti i sigurisë në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë, ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ai ndodhej në katin e parë të ndërtesës së komisarariatit dhe kishte 8 (tetë) dhoma sigurie. Ato ishin të evidentuara me etiketë dhe të ndara në 6 (gjashtë) dhoma për personat në moshë madhore (burra), 1 (një) dhomë për gratë dhe 1 (një) dhomë për të miturit.

Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë ishte për 9 (nëntë) persona të ndaluar/arrestuar. Dhomat e sigurisë plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>3</sup>

Dhomat e sigurisë kishin përmasa 4x4m, të ndara me skarrë hekuri në dy ambiente, në dhomë dhe në paradhomë. Në secilën dhomë kishte nga një krevat për fjetje dhe vetëm në njërin nga dhomat ishin vendosur 2 krevatë.

Brenda ambientit të dhomave të sigurisë kishte nga një krevat dhe një tualet. Ndërsa në paradhomë ndodhej një lavaman me çezëm që furnizohej me ujë të rrjedhshëm dhe shërbente për mbajtjen e higjenes personale, por dhe të ambientit të dhomës. Ambienti i dhomave ishte i pajisur me orënditë e nevojshme për jetesë përveç një krevati të fiksuar në dysheme, kishte dyshek, batanije dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë përdorimi dhe ishin të pastra.

---

<sup>3</sup>Kreu VIII, pika 3/3 të procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Dhomat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Dritaret e dhomave mundësonin hyrjen në dhoma të ajrit dhe dritës natyrale, por kishin edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Në rast ndërprerje të energjisë elektrike, komisariati i policisë kishte dhe një gjenerator si burim rezervë për sigurimin e ndriçimit në mjedisin e shoqërimit dhe të sigurisë.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej një aparat telefoni fiks dhe citofon, që përdoren nga punonjësit e shërbimit për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë, në rastet kur ka tentativav apo ngjarje të rënda nga të ndaluarit/arrestuarit. Gjithashtu, në çdo dhomë ishin të instaluara zilet e emergjencës, të cilat mundësonin personat e ndaluar/arrestuar për të njoftuar punonjësit e shërbimit të policisë në rast nevojë.

Në fundin e korridorit, ndodhej ambienti i dushit për larjen e trupit, i cili kishte postin e dushit dhe një bolier për ngrohjen e ujit. Për mbajtjen e higjenës personale, në çdo paradhomë ishin të instaluara nyjet hidrosanitare, si dhe çezma që furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm përgjatë 24 orëve.

Dhomat e sigurisë kishin kondicioner për ngrohje/ftohje që sigurohej nga një sistem qëndror, i cili ishte funksional.

Nga inspektimi u evidentua se, në mungesë të mjekut, vizitat mjeksore të personave të ndaluar/arrestuar dhe plotësimet e kartelave shëndetësore, kryheshin nga kryeinfermieri që ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër. Dhoma e mjekut, ishte e pajisur me orenditë e nevojshme krevat, tavolinë, raft për mbajtjen e kartelave shëndetësore dhe ilaçeve, frigorifer i vogël, si dhe karrige për qëndrimin ulur të personave.

Pjesa e jashtme e ambientit të sigurisë, korridori dhe hyrjet për në dhomat e sigurisë monitoroheshin nga sistemi i kamerave. Brenda ambientit të sigurisë ishin të instaluara 4 kamera për mbajtjen në vëzhgim përgjatë 24 orëve. Sistemi i kamerave administrohej nga specialisti i IT në DVP Gjirokastër dhe pamjet filmike ruheshin deri në 30 ditë.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma për marrjen në pyetje të ndaluar/arrestuarve nga përfaqësuesi i organit të akuzës, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takime me avokatët mbrojtës. Dhoma ishte e monitoruar me sistemin audio-viziv të kamerave, për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryheshin nga OPGJ gjatë marrjes në pyetje të këtyre personave. Kjo dhomë ishte e pajisur gjithashtu me tavolinë pune për oficerët e policisë gjyqësore dhe karrige për qëndrimin ulur të personave të ndaluar/arrestuar dhe punonjësve të policisë gjyqësore, me këmbë të fiksuara në dysheme.

Në kohën e inspektimit, në ambientin e sigurisë ndodhej një person në cilësinë e të arrestuarit. Nga verifikimi i regjistrimit ku evidentoheshin të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, për periudhën Janar-Maj 2022 ishin akomoduar 125 persona në kushtet e masës së sigurisë “arrest me burg”, nga të cilët 2 gra dhe 2 shtetas të huaj. Sipas

shënimeve në regjistër dhe statistikat e periudhës 5-mujore, nuk rezultoi të ketë patur situata mbipopullimi në dhomat e sigurisë. Koha e qëndrimit në dhomat e sigurisë e personave të arrestuar, ishte deri 96 orë për vleftësimin e masës së arrestit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Trajtimi me ushqim i personave të arrestuar/ndaluar kryhej 3 (tre) herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në VKM nr.189, datë 15.03.2017 *“Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”*. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me institucionin dhe ofrohej me shërbim catering.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Nga intervista me personin e arrestuar dhe nga informacioni i dhënë nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, rezultoi se, të ndaluar/arrestuarve u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe mbajtjen pastër të dhomave të sigurisë si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Këto produkte mbaheshin dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, nuk rezultoi të kishte raste apo pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike, nga punonjësit e policisë të komisariatit. Për vitin 2022, nuk ishte regjistruar asnjë ankesë nga personat e shoqëruar apo ndaluar/arrestuar, për keqtrajtimin e tyre nga punonjësit e policisë.

Nga intervista me drejtuesit e komisariatit, u evidentua se punonjësit e policisë gjatë shoqërimit apo ndalimit/arrestimit të shtetasve, identifikohen përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Personi i arrestuar që ndodhej në dhomat e sigurisë, deklaroi se në përfundim të veprimeve procedurale me personat e ndaluar/arrestuar, oficeri i policisë gjyqësore e kishte pajisur me kopje e urdhërit të ndalimit/arrestimit, procesverbalit të kontrollit personal dhe kopje e kartës me të drejtat që gëzojnë këta persona me masë sigurie “arrest me burg”.

Gjatë inspektimit, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre.**

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”<sup>4</sup> dhe “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, parashikohet se “*në çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës*”<sup>5</sup>.

Nga inspektimi u evidentua se, në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Gjirokastër, regjistrat ishin sipas inventarit të përcaktuar në procedurat standarde. Librat dhe regjistrat mbaheshin në raftet në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë dhe në zyrën e informacionit nga punonjësit e policisë. Administrimi dhe plotësimi i tyre kryhej nga punonjësit e policisë të ngarkuar me këtë detyrë. Regjistrat ishin të sekretuar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Nga verifikimi i dokumentacionit, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në komisariatin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistrë nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit<sup>6</sup>.

Gjithashtu, në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë të komisariatit ndodhej regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar dhe plotësuar sipas rubrikave. Nga kqyrja e regjistrit rezultoi se, në rastet e arrestimeve në flagrancë, ora e arrestimit të personit e shënuar në procesverbalin e arrestimit, përputhej me orën e shoqërimit të tyre që në momentin e hyrjes në mjedisin e komisariatit të policisë.

Duke qenë se, në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Gjirokastër, sigurohen dhe trajtohen dhe personat e arrestuar nga strukturat e policisë të komisariateve Përmet dhe Tepelenë, duhet që nga oficerët e policisë gjyqësore të këtyre komisariateve të shënojnë në urdhërat e arrestimit të personave të kapur në flagrancë, orën që këtyre shtetasve iu është privuar liria nga momenti i shoqërimit në këto komisariate dhe jo orën kur dërgohen në dhomat e sigurisë në Gjirokastër.

---

<sup>4</sup> *Kreu VII, pika 5 i procedurave standarde*

<sup>5</sup> *Kreu XI, pika 1 i procedurave standarde*

<sup>6</sup> *Kreu VII, procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*



U evidentua se, përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte në administrim dhe një regjistër të veçantë për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, sipas rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit<sup>7</sup>.

Ndërkohë, në zbatim të kërkesave të nenit 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, komisariati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar.

Për periudhën Janar - Maj 2022 ishin evidentuar 6 kërkesa të personave të arrestuar/ndaluar, që kishin si objekt njoftimin e familjeve apo pajisjen me avokat mbrojtës nga lista e miratuar nga organi i prokurorisë. Nisur nga shënimet në regjistër, kërkesat ishin të plotësuara nga punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë specialistët e policisë gjyqësore i kryenin përgjithësisht veprimet procedurale me shtetasit e shoqëruar në zyrën (salla) e punës të SPZ-ve, por edhe në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente, pavarësisht qëllimit të tyre, nuk plotësonin kushtet e një ambienti të veçantë për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, i cili duhet të jetë i monitoruar me kamera, sikurse përcaktohet në procedurën standarde: *“Personat e shoqëruar deri në sqarimin e pozitës dhe arsyes së shoqërimit mbahen në ruajtje dhe monitorim të punonjësit të policisë të funksionit të caktuar ose me mjete të tjera dixhitale (sisteme të kamerave video – audio)”*<sup>8</sup>.

Ndërsa, në ambientet e sigurisë të komisariatit kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesi i organit të akuzës, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takim me avokatët mbrojtës, ku ishin instaluar kamera për vëzhgimin e veprimeve që kryhen me këta shtetas.

Në lidhje me intervistimin/marrjen në pyetje të persona të mitur, sikurse e përmendëm edhe më lart, ishte krijuar “Njësia për intervistimin e të miturve”, e cila ndodhej brenda teritorit të komisariatit të policisë. Ky ambient përbëhej nga 4 dhoma të ndara më vete, të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina për punën e specialistëve të policisë, si dhe karrige për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës. Stafii i policisë përbëhej nga 2 specialistë policie të trajnuar për këtë qëllim. Në tavolinat e punës dhe në mure ishin vendosur materiale informuese mbi të drejtat e të miturve kur ndodhen në mjediset e policisë, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga punonjësit e policisë gjatë intervistimit të tyre.

---

<sup>7</sup> Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 drejtuar Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

<sup>8</sup> Kreu VII, pika 5/ç e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Për periudhën Janar-Maj 2022, në “Njësinë për intervistimin e të miturve” ishin intervistuar 41 të mitur, sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë për të Miturit dhe procedurën standarde. Të miturit ishin të evidentuar në një regjistër të veçantë.

Nga monitorimi që iu bë ambienteve të punës dhe zyrave të punonjësve të policisë në Komisariatin e Policisë Gjyrokastër, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Sipas informacionit të punonjësve të policisë, u evidentua se zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien çdo personi të shoqëruar, kopje të procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë të ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi u evidentua gjithashtu se, në zyrën e informacionit ndodheshin dhe fashikujt me formularin tip “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”, si dhe procerverbali i shoqërimit, që ishin të plotësuar sipas rubrikave. Këta formularë ishin të firmosur nga punonjësit e policisë që ishin marrë me trajtimit e rasteve, si dhe nga personat e shoqëruar. Nga informacioni, personat e shoqëruar në mjediset e policisë pajiseshin gjithashtu edhe me letrën e të drejtave, që në momentin e hyrjes në ambientet e komisarariatit.

Për personat e ndaluar/arrestuar, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/1.b dhe pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, ku thuhet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të letrës me të drejtat që gëzojnë këta persona, si dhe kopje të procesverbalit nëpërmjet të cilit ata njihen me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tyre.

Në takimin që grupi i inspektimit zhvilloi me punonjësit e policisë që kryenin veprime procedurale me shtetasit e shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar, u evidentua se, zbatohet detyrimi ligjor për të informuar këta shtetas që në momentin e hyrjes në mjediset e policisë së shtetit, se në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat mbrojtës, mund të kërkojnë ndihmë juridike falas dhe ti ofrohet një avokat mbrojtës kryesisht, nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Nisur nga rastet e ngjarjeve të rënda me pasojë vdekjen e shtetasve që kanë ndodhur gjatë viti 2022 në komisarariatet e policisë Kamëz dhe Kavajë, në lidhje me zbatimin korrekt të rregullave dhe procedurave të kontrollit të personave të ndaluar/arrestuar, sjellim në vëmendje tuaj nevojën e verifikimit të plotë nga punonjësit e policisë, të gjendjes fizike e shëndetësore të këtyre personave para se të hyjnë në ambientin e sigurisë. Gjatë ushtrimit

të kontrollit nga oficerët e policisë gjyqësore, por edhe mjekut gjatë kryerjes së vizitës mjekësore, duhet kujdes për të dalluar nëse kanë shenja të dëmtimeve në pamjen e jashtme, nëse kanë apo jo sende të ndaluara, si dhe të evidentojnë me përgjegjësi çdo veprim, sjellje dhe qëndrim tjetër që tregon nëse personi vuan nga ndonjë sëmundje mendore, apo gjendje shëndetësore e veçantë.

Lidhur me këto çështje, për të mënjeluar përgjegjësinë e autoriteteve të policisë, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT), në raportin për vizitën e tij në Shqipëri botuar në vitin 2019, midis të tjerave ka rekomanduar: *“Marrjen e hapave të nevojshëm për të siguruar zbatimin e dispozitave të përcaktuara në manual/procedurë për trajtimin dhe sigurimin e të paraburgosurve/arrestuarve për kryerjen me rigorozitet të ekzaminimit mjekësor fillestar të personave të ndaluar/arrestuar, duke marrë parasysh vëzhgimet e mësipërme”*<sup>9</sup>.

Në lidhje me shtetasit e huaj të shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar, karta e të drejtave ishte përkthyer në disa gjuhë të huaja, si anglisht, spanjisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe gjuhën rome.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të DVP Gjirokastrë. Në raste të veçanta, psikologu sigurohej dhe nga Bashkia Gjirokastrë.

Nga verifikimi i regjistrit të mjekut, vizitat mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar kryheshin brenda afatit 12 orë nga momenti i hyrjes të këtyre personave në ambientin e sigurisë. Vizitat mjekësore në mungesë të mjekut, kryheshin nga infermieri. Në rast të urgjencave apo vizitave mjekësore të mjekët specialist, përgjegjësi i dhomave të sigurisë njoftonte menjëherë urgjencën e Spitalit Rajonal Gjirokastrë. Konstatimet e kontrollit mjekësor pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjitashtu, për çdo person të ndaluar/arrestuar ishin hapur kartelat shëndetësore, të cilat ishin pjesë e fashikullit përkatës për secilin prej tyre dhe administrohen nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të

<sup>9</sup> CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018.

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

tjerash se: “*Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.*”.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Të organizohen trajnime të vazhdueshme me punonjësit e policisë që kryejnë shërbime në mjediset e shoqërimit dhe të sigurisë, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të tyre për zbatimin rigoroz të rregullave dhe procedurave ligjore, në lidhje me trajtimin e shtetasve në bazë të të drejtave të tyre ligjore dhe standardeve më të larta, duke respektuar dinjitetin njerëzor dhe integritetin fizik e moral të tyre, për kohën që ata qëndrojnë në mjediset e policisë së shtetit, sikurse parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
2. Të merren masa të menjëhershme për përfundimin e rikonstruksionit dhe vënien në funksion të dhomës së shoqërimit për të mitur.
3. Të merren masat e nevojshme, për instalimin e sistemit të kamerave në zyrën(sallën) e punës të SPZ-ve ku merren në pyetje personat e shoqëruar në mjediset e komisariatit, me qëllim mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me të shoqëruarit.
4. Të merren masa të menjëhershme, për instruktimin e personelit të shërbimit në ambientin e shoqërimit, me qëllim informimin dhe dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar/arrestuar apo të ndaluar, që në momentin e hyrjes në mjediset e komisariatit të policisë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**